



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-45783 dt. 24.08.2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **31.08.2022** (e Mërkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 27.07.2022.
2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
3. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim Vendim për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e Qytetit Glllogoc.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klub Fitness Koca.
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit Volejbolli për Femra të OJQ-së KV Gryka .
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së „KF FORTUNA”
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Boksit Drenas
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi Publik i Futbollit Drenas
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së FC LIQENI Drenas
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli
Meshkujt Drenas
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli
Femrat Drenas
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit botim i Librit monografi RFBSH Nezir Prokshi Drenas.
14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoha.
15. Njoftim rreth shkëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
16. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.
17. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
18. Të ndryshme.

Drenas, 24.08.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 24.07.2022, si vijon:

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e KPF-ca, për rendin e ditës, dhe i njoftoi anëtarët e KPF-së se kemi edhe dy pika shtesë për rendin e ditës:

1. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.
 2. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
- Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera për rendin e ditës kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës dhe votuan me: **06 vota (për), abstenim 0, kundër 0.**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. a. 20. 07.2022.

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, u kaloj me vota unanime.

2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
- U votua me 05 vota (për), abstenim 1, kundër 0.
3. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
U votua me 06 vota (për), abstenim 0, kundër 0.
4. Propozim Vendim për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e Qytetit Glllogoc.
U votua me 06 vota (për), abstenim 0, kundër 0.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klub Fitness Koca.
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit Volejbolli për Femra të OJQ-së KV Gryka .
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së „KF FORTUNA”
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Boksit Drenas
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi Publik i Futbollit Drenas
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së FC LIQENI Drenas
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli **Meshkujt** Drenas
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli **Femrat** Drenas
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit botim i Librit monografi RFBSH Nezir Prokshi Drenas.
Prej pikës të pestë deri te pika e trembëdhjete u votua me 05 vota (për), abstenim 1, kundër 0.
14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoba.
U votua me 06 vota (për), abstenim 0, kundër 0.
15. Njoftim rreth shkëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
-Rekomandohet për Kuvend
16. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.

U votua me 06 vota (për), abstenim 0, kundër 0.

17. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.

-Rekomandohet për Kuvend

18. Të ndryshme.

Pati kërkesa dhe diskutime në interes të qytetarëve dhe mbledhja përfundoi në ora 11: 10





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-45777 dt. 29/08/ 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.07.2022**


Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 24.06.2022.
2. Raporti Financiar Janar-Qershor 2022.
3. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
4. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
5. Propozim vendim për ndërrimin e statutit të Institucionit Arsimor Publik Parauniversitar-Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMPL) "Fehmi Lladrovci" të kaloj në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional (IAAP)
6. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve.
7. Propozim vendim për rialokimin e mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale brenda kategorisë.
8. Draft Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet urbane në Komunën e Drenasit.
9. Propozim vendim bartja e mjeteve financiare nga kategoria rezerva.
10. Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030
11. Të ndryshme.



Të mërkurën me dt.27.07.2022 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 11 pika për rend dite.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit, qytetar.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal.

Egzona Tërdevci, për arsye se nuk e kemi të kompletuar materialin për pikën e tretë propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër.

Azemine Bujupi-Gjoka, edhe ne mendojmë se pika e tretë të shtyhet për arsye se ka shumë pak të dhëna lidhur me këtë pikë edhe një arsyetim shumë i thjesht sepse është absurde gjitha këto parcela me u dhënë me një arsyetim shumë të thjeshtë, mendoj që me u shty kjo pikë për seancën tjetër.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, ne e kemi obligim ligjor listën e pronave me e dërgua në kuvend me aprovua për me mujt me e zënë edhe kohen për me i zhvillua edhe procedurat tjera, nëse diçka po mungon e ju e dini që po mungon na tregoni që ne ta kompletojmë, asnjë gjë sipas neve dhe ligjit nuk i mungon materialit, ju ftoj me e votu rendin e ditës se bashku me piken e tretë.

Azemine Bujupi Gjoka, një arsyetim shumë i thjeshtë, siç e keni shkruar ju si interes i qytetareve, unë doja ta marrë një certifikatë të statutit të këtyre parcelave që doni me i dhënë në shfrytëzim nuk kanë destinim të njëjtë sikur ju që na keni dërguar neve sikur ato që i shikova në sistem, psh parcela e parë shërbim tregtar komercial këtu është truall-shtëpi nuk e kanë emrin e njëjtë, pastaj tokë bujqësore a doni me e nderru destinimin e kësaj tokë bujqësore që me herët nuk keni dhënë për ndërtim pa e bërë destinimin e kësaj pjese.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, gjitha parcelat që janë në listën e pronave që kanë me u dhënë në shfrytëzim janë sipas ligjit ndërsa se për çka do të jepet prona dihet kur komisioni formohet dhe komisioni i përcakton kushtet dhe kriteret për çka ka me u dhënë prona dhe çka aplikojnë ata se donë me e marrë pronën në shfrytëzim është çështje e tyre pra ka kritere të cilat i përcakton komisioni.

Egzona Tërdevci, certifikatat dhe kopjet e planit që na u kanë përcjell neve janë të vjetra nuk e di nëse e paraqesin gjendjen faktike pasi që për 12 ngastra që janë të planifikuara me u dhënë në shfrytëzim vetëm për tri janë certifikatat dhe kopjet e planit të dt. korrik 2022 të tjerat janë krejt ma herët, po ashtu edhe unë kam dyshuar të arsyetimi se ky propozim vendim ka ardhë në bazë të komisionit vlerësues për dhënin e pronës në shfrytëzim të cilit komision e kemi shfuqizua thjesht ka mbetë ashtu shabllon.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, komisioni të cilin e kemi formuar është pasi ta votojmë këtë listë ai merret me atë punë, listën duhet me e dërgu para vitit të ri se cilat pronat të veta komuna ka me i dhënë në shfrytëzim, lista e cila ka ardhë është lista e cila është miratuar para vitit të ri që duhet me u miratu me ligj dhe u miratu me ligj nga kuvendi, këtë liste e kemi sjellë sot në kuvend me i dhënë dritë jeshile me fillu me i zhvillu procedurat. Ju ftoj me votu rendin e ditës me të gjitha pikat.

Arbër Halilaj, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj pike si dhe faktin që e dimë që është në kompetenca e Kuvendit Komunal që të merret me pronat dhe dhënien e tyre në shfrytëzim, po ashtu të gjithë në këtë sallë jemi për zhvillim ekonomik të Drenasit për thithjen e investimeve të reja mirëpo e shoh që nuk kemi informata jo vetëm për këto parcela por as për parcelat e mëhershme sepse nuk është hera e parë që komuna jep parcela në shfrytëzim mirëpo nuk kemi informata cili është interesi publik që synohet të arrihet, përshkrimin e sakt të destinimit të parcelave, përfitimin ekonomik të parashikuar të komunës, sa janë këto parcela në harmonizim me planin zhvillimor komunal apo hartën zonale, dhe duke mos i pas këto ne nuk mund vlerësojmë se sa po përfillen parimet që cekën në nenin 4 të ligjit për dhënien në shfrytëzim të tokave komunale. Prandaj jam për ta shtyrë piken e tretë për seance tjetër vetëm për arsye të kompletohet këto që i ceka me lartë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, ne nuk mund ta bëjmë llogarinë se sa është përfitimi i komunës para se me e shpall interes dhe para se me apliku njerëzit për me i marrë këto prona, çdo shtyrje e kësaj pike e dëmton që pronat nuk po jepen në shfrytëzim dhe komuna nuk po përfiton nga pronat e veta, unë ju ftoj me e votu sepse është në interes të komunës në interes të zhvillimit ekonomik të komunës, në interes të punësimit dhe në interes të asaj që komuna përfiton.

Pas diskutimeve, vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 14 anëtar, 6 vota kundër, 5 vota abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 24.06.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër 1, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti Financiar Janar-Qershor 2022.**

Nuk pati diskutime sa i përket pikës së dytë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës. **3. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).**

Egzona Tërdevei, për subjektin politik të cilin unë bëj pjesë, prona publike është e shenjte dhe si e tille mund te jepet në shfrytëzim vetëm në situatën kur me te vërtetë i kontribuon interesit publik, ne nuk mundemi me kaq lehtësi dhe me informacione kaq te mangëta të votojmë që mbi 50 ha pronë publike e komunës tonë të kaloj në shfrytëzim privat për 99 vite, duke u bazuar të ligji 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 14 pika 2 thuhet se propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme te komunës duhet të identifikoj të dhënat kadastrale të pronës, madhësisë e saj të specifikoj arsyen, qëllimin, kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënien e pronës në shfrytëzim, në këtë propozim vendim nuk specifikohen as arsyet e as qëllimi për dhënien ne shfrytëzim të të pronës publike, në dokumentet që i keni sjellë ju dhe bazuar në këtë nen mungojnë disa elemente të rëndësishme për këtë propozim, tek pjesa e arsytimit paragrafi i dytë nis me fjalën komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave e dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të komunës, tregona se qfar komisioni po i referohemi, komisioni është formuar me dt: 23.02.2022 dhe pas shkresës nga MAPL ky vendim është shfuqizuar me dt. 27.04.2022. tek neni 14 pika 2 kundër te tjera thuhet se propozim vendimi duhet të identifikoj arsyet dhe qëllimin për shfrytëzimin e pronës komunale, ne nuk kemi një pasqyre të qartë se për çfarë arsye do të shfrytëzohen këto prona dhe cili do të jetë qëllimi i përdorimit të tyre, në propozim ju thirrreni se keni marrë kërkesa nga persona fizik dhe juridik për këto prona, ndani edhe me ne këto kërkesa t'i shikojmë edhe ne nëse vërtetë do të ketë ndikim pozitiv ky propozim në ekonominë dhe zhvillimin e qytetit tonë, për të pasur një vlerësim të drejt rreth dhënies të këtyre pronave ne kemi nevojë ditë se cilët janë investitorët që i kane dërguar këto kërkesa për shfrytëzim të këtyre pronave, a kane plane biznesi këta investitor sa është numri i vendeve te reja të punës që mund te hapen nga dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave, rreth kësaj pike kemi nevojë edhe për disa sqarime tjera. Janë disa probleme lidhur me pronat, dy ngastrat kadastrale që i kane propozuar për fshatin Glllobar përkatësisht ngastra 438/4 dhe 438/5 në certifikatën e pronës është shfrytëzimin aktual e kane të shkruar si kullosë, të nderuar aktualisht aty janë dy biznese të cilat operojnë a ka ndonjë marrëveshje paraprake për shfrytëzim të kësaj toke ku ato dy biznese janë duke u shfrytëzuar ilegalisht këtë pronë publike. Në të njëjtin fshat ngastra kadastrale 14/0 në Glllobar po propozohet të jepet në shfrytëzim 47 ha tokë pyjore në shfrytëzim, a jeni te vetëdijshëm për rëndësinë e asaj pjese të fshatit jo vetëm për fshatin tonë por edhe për gjithë qytetin tonë. Në kornizën afatmesme buxhetore ju jeni zotuar se brenda tri viteve do të ketë investime për ta shndërruar atë vend në park funksional me infrastrukturë përcjellëse a nuk bie ndesh ky propozim vendim me

propozimin tuaj për park, sipas mendimit tonë pishat nuk do duhej t'i jepen në shfrytëzim askujt pasi që nuk mund të rrezikojmë që ajo bukuri natyrore të dëmtohet duke pas parasysh që pas katër viteve përdorim të pronës publike mund t'i ndërrohet destinimi, nuk besoj se mund të ekzistoj një arsye mjaft bindëse sa për të dhënë në shfrytëzim 47 ha bukuri natyrore të qytetit tonë. Një nga pronat që po propozohet të jepet në shfrytëzim është edhe pjesa e tokës ku gjendet objekti i vjetër i komunës, aq sa kemi informacione këshilli për veprim rinor lokal dhe organizatat e tjera e shfrytëzojnë këtë objekt si zyre gjithashtu edhe në këtë pjesë gjendet shtëpia e kulturës se qytetit a është menduar zgjidhja për këto kategori dhe a nuk do të ishte më e rrugës që kjo tokë të shfrytëzohet të ndërtohet një objekt edukativo-kulturor që do të mund të përdoret edhe nga te rinjtë po ashtu të shërbej si salle e kulturës apo teatro e qytetit, gjithnjë ky propozim vlen vetëm nëse është e pamundur renovimi i objektit. Fshatin Korreticë e Eperme është propozuar të ipet në shfrytëzim ngastra 34-0 sipërfaqe kjo përball parkut të biznesit, a i kontribuon kjo zgjerimit të parkut të biznesit, në Komoran ngastra 1980/0 nga ajo që dimë njëherit iu është dhënë në shfrytëzim një pronari në vitin 2014, marrëveshje e prishur kjo nga qeverisja juaj ne vitin 2018 a mund të na konfirmoni nëse ka ndonjë proces gjyqësor të iniciuar lidhur me këtë pronë, në propozim vendim për ngastrën kadastrale 244/4 e keni shkruar sipërfaqen 1863 m² kurse në certifikatën e kësaj ngastre ne kopjen e planit për këtë ngastër është 1893 m² duke i shikuar gjitha këto elemente të cekura më lartë kërkoj që këtë diskutim me e shty për një here tjetër edhe pse u miratu rendi i ditës pasi që neve na duhet këto elemente shtese për të marrë vendim për këto çështje. Po flasim për mbi 50 ha tokë pronë publike dhe koha për të cilën këto prona po synohen të ipen ne shfrytëzim është tepër e gjatë përveç se po prezantoj qëndrimin e subjektit politik prej nga vijmë rreth ndjeshmërisë me prona publike, pa e kompletuar materialin kërkoj që të mos votojmë për këtë propozim vendim.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nuk është ai komision i cili e përcakton listën e veçantë para se me e dërgua në MAPL për ta deklaruar për vitin e ardhshëm, ai komision është një komision i verifikimit për liste të veçantë i cili ka qenë për mandatin e kaluar, pra i ka ndej procedurat dhe e ka përcaktuar listën të cilën e ka votua kuvendi dhe të cilën e ka miratu apo i ka dhënë vlerësim ligjshmërie MAPL-ja. Fole për një pronë të parku i biznesit ne nuk kemi prona të parku i biznesit, kush e sjelle ofertën më të mirë projektin më të mirë ka me kalu nga komisioni.

Egzona Tërdevci, për Komoran ishte fjala ngastra 1980/0?

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, parcelën që e ceke në Komoran nuk është në proces gjyqësor.

Arbër Halilaj, duke pasur parasysh rëndësinë e pikës që po diskutojmë sa i përket zhvillimit lokal ekonomik të komunës sonë si dhe transparencës në raport me qytetarët që na dëgjojnë tani, dua të theksoj së pari faktin se në bazë të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 5 e përcakton statusin ligjor të komunës si subjekt juridik, i cili ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë me pronat. Gjithashtu, tek Neni 17 i cili përcakton kompetencat vetanake të komunës, theksohet se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;

d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; pra, që të katër të parat kanë të bëjnë me pronat, ndërtimin dhe zhvillimin ekonomik. Ne sot kemi si pikë të rendit të ditës një Propozim-vendim shumë të rëndësishëm për dhënien e pronave të paluajtshme komunale në periudhë afatgjatë për 99 vite tek personat fizik apo juridik.

Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës do të duhej të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës, pra tokës dhe objekteve, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik si dhe rritje të vlerës së pronës në shërbim të interesit publik apo të përgjithshëm. Ky ligj krijon edhe mundësinë e përfitimit të së drejtës së pronësisë nga komuna mbi pronat që i administron shteti apo AKP-ja.

Është mirë që ekziston infrastruktura ligjore për këtë qëllim, përmes Ligjit të lartcekur dhe akteve e rregulloreve tjera, sepse përmes tyre, në këtë rast komuna jonë e ka më të lehtë tani dhe në të ardhmen të arrijë synimin që ta bëj Drenasin ambient atraktiv për investime vendore dhe të huaja. Çështjet kyçe që i adreson Ligji tek Dhënia në Shfrytëzim dhe Këmbimi i Pronës së Paluajtshme të Komunës janë:

- Procedurat e përcaktuara se si përzgjedhet një investitor privat,
- Procedurat për negociim të marrëveshjeve dhe rrethanat kur mund të negociohen ato pa procedura konkurruese, pra nga ana e Kryetarit me kompetencat që ka,
- Ndërtimi i një sistemi elektronik që përfshinë regjistrin e të gjitha pronave të paluajtshme komunale dhe përcaktimi i destinimit të tyre,
- Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme për qëllim të ndërtimit të institucioneve parashkollore dhe shkollore, objekteve kulturo-sportive, hapësirave banuese kolektive për familjet në përkujdesje social, pra objekteve investive të interesit të përgjithshëm publik ,

Meqë sot po flasim për prona komunale që planifikohet të jipen në shfrytëzim për afatin maksimal ligjor prej 99 vite, duhet të lëmë anash bindjet partiake politike dhe të rikujtojmë që këtu jemi për interesin publik e qytetar që e përmend në shumë vende edhe Ligji i lartcekur për dhënien në shfrytëzim. Nuk është hera e parë që komuna jonë jep tokë komunale në shfrytëzim qoftë afatgjatë e qoftë në afat më të shkurtër, për të realizuar strategjinë për zhvillim ekonomik lokal, por rezultatet nga ky proces duket se mungojnë. Bile, gjithnjë ka pas pretendime kryesisht të natyrës që X-parcela që po jipet në shfrytëzim është në kontest gjyqësor, pastaj ndërrohet destinimi për çka është dhënë në shfrytëzim parcela etj. dhe unë sot në fakt nuk kam informata se sa prona komunale janë dhënë në shfrytëzim gjatë mandatit të këtij ekzekutivi komunal, për çfarë destinimi dhe në çfarë periudhe janë dhënë, çfarë plani biznesi ose tjetër kanë implementuar individët apo bizneset përfituese, sa veta nga komuna jonë i kanë punësuar, cilat dhe sa kanë qenë përfitimet financiare të komunës, si qëndrojnë këto parcela në raport me PZHK dhe HZK etj.

Këto informata me vlerë janë të domosdoshme para se të hyjmë në një raund tjetër të dhënies në shfrytëzim të tokës komunale, e ne nuk i kemi as për parcelat e mëhershme e as për këto tani.

Duke mos i pasur këto informata nga periudha e kaluar, por as përshkrimin e saktë të destinimit të parcelave të tanishme, interesit publik që synohet të arrihet dhe përfitimit ekonomik të parashikuar të komunës, ne nuk do të mund të vlerësojmë se sa po përfillen në këto procese parimet që ceken në Nenin 4 të Ligjit gjatë dhënies së parcelave në shfrytëzim, e që janë:

1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;

1.2. Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe

sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;

1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke *shmangur çdo diskriminim ndaj palëve* dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

1.4. Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrën që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;

1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se, shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Kësisoj, për të mbrojtur ne asamblistët interesin publik, ashtu siç edhe e kemi obligim, janë përcaktuar disa kritere në të cilat bazohet procesi që po e diskutojmë sot, e të cilat duhet t'i kemi parasysh:

1. së pari, parcelat që janë në diskutim për dhënie në shfrytëzim duhet të jenë *të regjistruara në regjistrat kadastral të pronës komunale*, që duket se janë;
2. *qëllimi* për të cilin prona e paluajtshme e komunës po jepet në shfrytëzim duhet *të jetë i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor*;
3. dhënia në shfrytëzim të arsyetohet me *interesin publik apo përfitimin ekonomik të komunës*;
4. parcela të plotësojë *kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore*.

Kriteri i parë teknik besoj që është plotësuar meqë i kemi certifikatat nga regjistri kadastral për këto parcela, ndërsa nuk kemi asnjë përshkrim më të detajuar për tri pikat tjera. Pra, dhënia në shfrytëzim e pronës komunale ka për bazë qëllimin e përmbushjes së interesit publik, duke iniciuar procedurat dhe përmbushur kushtet e përcaktuara për këtë proces. Askush këtu nuk jemi kundër zhvillimit ekonomik të Drenasit, kundër interesit publik, pastaj eliminimit të burokracisë sa i përket procedurave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, vendimi i sotëm mundëson edhe zhvillimin e negociatave nga ana e kryetarit të komunës me investitorët potencial dhe krijohet një ambient që do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal etj. krejt këto janë të qarta, siç është e qartë ngutia e panevojshme me këtë çështje dhe mungesa e informatave për një proces kaq të rëndësishëm, dje, sot dhe kurdo që inicohet.

Por, unë e kam një princip jetësor që mësoj nga informatat e të kaluarës, për të pasur të ardhmen sa më të parashikueshme, duke mos harruar që njerëzit e mbajnë në mend më së shumti faktin se si i ke bërë të ndihën.

Bazuar në këtë princip, kurdo që gjendem në një pozicion si sot kur një çështje shumë e rëndësishme tentohet të kalohet pa u arsyetuar mirë parimet dhe kriteret që e shoqërojnë si proces, vota ime do të jetë kundër.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, pronat i kemi kaluar verifikimin në gjithqka edhe në Ministri të Pushtetit Lokal janë deri në 99 vjet, ka dikush që mundet me i marrë për 15 vjet, gjitha kto që i ke fol ti janë në fazën tjetër, janë në fazën kur caktohet komisioni për me i zhvillu procedurat të shpalljes publike të këtyre pronave pra në komision do të jete në përbërje nga dy asamblistë, dy ekzekutiv, një OJQ pra gjitha këto i përcaktojnë komisioni që i

ceke me lartë pra janë në fazën tjetër, nuk jemi duke e shkel asnjë procedure jemi duke provu me i dhënë mundësi zhvillimit të komunës edhe mbi bazën e këtyre pronave të dhëna në shfrytëzim, në qeverisjen 4 vjeçare Kuvendi i ka dhënë 4 prona,

Arbër Halilaj, të paraqitja tabelare e listës së pronave për me shiku se pse po kerkojmë më shumë informata është ngastra kadastrale, sipërfaqja, zona dhe destinimi, qka kuptoni me destinim shërbim tregtar, komercial ndërtimor, në vetëm po kërkojmë më shumë informata argumente që me e votu këtë listë që e ka qëllimin zhvillimi e ekonomik të Drenasit, dhe na jepni shembuj që me qenë të bindur që ata që aplikojnë do të kontribojnë zhvillimit ekonomik të Drenasit.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, komisioni e përcakton çka ka me qenë edhe ata që aplikojnë vetëm xhamia edhe kisha nuk mundemi me i dhënë në shfrytëzim, vetëm për ato veprimtari që janë më ligj të sanksionune më ligj në Kosovë të tjerat kemi të drejtë me i dhënë, ky është proces i cili duhet me i hap rrugë gjitha ato që i ceke.

Albulena Saliuku, një nder faktorët dërtiminues në rritjen ekonomike janë investimet e ndryshme, me miratimin e këtij propozim vendimi me dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim, pra investimet në fusha të ndryshme do të kemi rritje në zhvillimin ekonomik, miratimin e konsideroj të rëndësishëm meqë do të kemi edhe rritje të mirëqenës së qytetareve tanë, pra ne këtu jemi të gjithë për interesin e qytetareve tanë prandaj duhet ta votojmë këtë propozim vendim.

Maridona Bazaj, ne nuk jemi kundër bizneseve dhe zhvillimit ekonomik të Drenasit se nëse një investitor e ka pas në shfrytëzim një pronë ka punu dhe investu në të është mëkat nëse nuk ia vazhdojmë shfrytëzimin e asaj pronë, mirëpo problemi është se çështja e investitorëve të rinjë nuk po e dimë se kush janë dhe çka kane me investu, çështja tjetër pse komuna e vjetër me u dhënë në shfrytëzim për ndërtime të larta kur në Drenas qdo ditë e më shumë qytetaret po ikin nga vendi dhe do të mbetet i zbrazet.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, ne nuk e dimë se kush ka me apliku dhe kush ka me e marrë, unë nuk e di se ata që do të aplikojnë se çfarë projekti e sjellin a do të behet ndërtim a çka do të behet nuk e dina. Objektin e vjetër as nuk mundemi me ia lenë KVRL-së as askujt pra objekti është jashtë çdo niveli për me kry veprimtari aty, ne duhet me e liru pronën për me pas mundësi me zhvillu atë vend aty.

Labinot Halilaj, në këtë seance në vetëm po e dhajmë dritën jeshile të pronave publike në dhënien në shfrytëzim për 99 vite, në këtë seance nuk jemi duke i dhënë pronat publike por jemi duke ia dhënë dritën jeshile ekzekutivit për me i zhvillu procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës publike, ne duhet me votu këtë propozim vendim për dhënin e pronës për 99 vite.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, ju ftoj ta votoni këtë pikë të rendit të ditës me pastaj komisioni i përcakton kriteret.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, (Për) votuan 15 anëtar, 9 kundër, 2 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Nuk pati diskutime sa i përket pikës së katër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për ndërrimin e statutit të Institucionit Arsimor Publik Parauniversitar-Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMPL) "Fehmi Lladrovci" të kaloj në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional (IAAP).**

Albulena Saliuku, është për tu vlerësuar shumë puna e Drejtorisë së Arsimit, Drejtorit të shkollës, e mësimeve dhe e gjithë stafit, me ndërrimin e statutit të Institucionit Arsimor Publik Parauniversitar-Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMPL) "Fehmi Lladrovci" të kaloj në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional ky institucion do ta ketë peshën dhe rëndësinë e njëjtë dhe do t'ia hap rrugën nxënësve për më shumë mundësi për profile të reja dhe drejtime të reja për tregun e punës.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, **(Për)** votuan 00 anëtar, kundër 0, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, **(Për)** votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për rialokimin e mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale brenda kategorisë.**

Mërgim Pirraku, me këtë ridestininim të mjeteve keni planifikuar 11 projekte kapitale kryesisht janë kanalizime dhe asfaltim të rrugëve, unë e kam vërejtur që keni bërë disa diskriminime për disa fshatra psh. Fushtica e Ulet dhe Fushtica e Lartë i keni realizuar 10 ose 15 projekte me një fshat ndërsa me një fshat tjetër asnjë projekt, kërkoj një arsyetim pse i keni paraparë 11 projekte kapitale pse kanë qenë prioritet për juve e disa kërkesa tjera psh nga administratori i fshatit Sankoc keni pranuar disa kërkesa për vazhdimin e 1300 m të kanalizimit dhe këtu nuk e keni planifikuar, unë konsideroj si jo korrekte edhe kërkoj nga ju me i barazua fshatrat, sepse nuk është korrekte disa fshatra me i realizua 10 projekte ndërsa në disa fshatra 1 ose 2 projekte. Kërkoj që kjo pikë mos të votohet dhe të rishikohen prioritetet edhe një herë dhe të parashikohet vazhdimi i kanalizimit në fshatin Sankoc.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, ky është kalim i mjeteve prej mjeteve të cilat i kemi paraparë për sheshin i cili ka shku në OSHP dhe për shkak të vonësive në nuk mundemi e i zhvillu dhe këto mjete jemi detyruar me i dergu të projektet të cilat janë në zhvillim, ato të cilat janë në zhvillim ku na mungojnë mjetet për projektet të cilat i kemi zhvillu, ne vetëm i alokojmë këto mjete nuk bëjmë diskriminime.

Albulena Saliuku, ridestininimi i projekteve për rialokimin e mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale në lidhje me asfaltimin e rrugëve si dhe rrjetin e kanalizimit të ujerave të

zeza për fshatrat e cekura janë shumë të nevojshme ku miratimi i këtyre mjeteve do ta përshpejtoj procesin e përfundimit të këtyre projekteve sigurisht që këto janë edhe kërkesa të vazhdueshme të qytetareve, kërkesë e vazhdueshme e bashkëvendësve të mi të fshatit Gradicë është përfundimi i kanalizimit të ujerave të zeza në pjesët ku nuk është përfunduar ende, është punuar në fshatin tim por më urgjente është që të përfundoj kanalizimi i ujerave të zeza nga shkolla deri tek lagjja Muja ku përfshihet edhe lagjja Dibrani, e nevojshme shumë që të finalizohet shpejt si projekt për arsye të frekuentimit të përditshëm të rrugës kryesore nga banoret sidomos nga fëmijët. Këto projekte janë të rëndësishme që të përfundohen me miratimin e këtyre mjeteve edhe për fshatrat e tjera si Likoshan, Godanc, Dobroshefc si dhe Qikatovë e vjetër si dhe fshatrat e tjera, pra behet fjalë për asfaltimin e rrugëve dhe kanalizimin e ujerave të zeza. Kërkoj që ta miratoi këtë propozim vendim.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, (Për) votuan 21 anëtar, 5 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Draft Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet urbane në Komunën e Drenasit.**

Egzona Tërdevci, shumë mirë që po miratohet një draft rregullore për administratoret e fshatrave dhe Lagjeve urbane, me të vërtete e kanë pas të vështirë funksionimin dhe as nuk janë kompensuar për punën që e kanë bërë, por as nuk e kanë pas një rregullore të përcaktuar të funksionimit. Unë i kam dy çështje që dua t'i ngriti, ndarja e administatoreve që është bërë e kam shikuar dokumentin e dëgjimit publik që e keni mbajtur edhe administratori i Sankocit është anku që mundet me i menaxhua tri fshatra, Sankoci, Fushtca e Eperme dhe Fushtica e Poshtme, draftin fillestar që e keni përcjell që e keni publikuar në faqen e Komunës Fushticat kanë qenë bashkë ndërsa Sankoci ka qenë i ndarë, a mendoni se mundet me funksionu në këtë formë a është dashtë patjetër me i fuzionua të trijat?

Çështja tjetër të formimi i këshillave lokale përkatësisht të pika e dytë thuhet se këshilli duhet me reflektua edhe përbërjen gjinore por nuk ka imponim, a mundemi me e dhënë si propozim prej kuvendit komunal që një këshill i fshatit apo i lagjes urbane mos me mujt me u formu nëse nuk e ka të paktën një grua në këshill.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, sa i përket rregullores paraprake e ceket që nuk ka pas rregullore me herët mirëpo ka qenë një rregullore është e vitit 2013, sa i përket se a mundet një administrator me i menaxhua dy apo tri fshatra kjo është e rregulluar me udhëzim administrativ 02/2019 i cili e përcakton në bazë të numrit të banoreve se sa këshilla lokale duhet të jenë. Neni 4 pika 2.5 e kësaj rregullore e përcakton se sa duhet të jetë numri i administatoreve kështu që ne duhet t'i përmbahemi kësaj rregullore, e kemi të vështirë sepse duhet të reduktohen administratoret nga 44 sa kanë qenë në 25 megjithatë kështu e parasheh rregullorja dhe duhet t'i përmbahemi asaj.

Azmine Bujupi-Gjoka, Draft Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet urbane në Komunën e Drenasit siç po shihet këtu ka me u bërë një fuzionim i administatoreve të fshatrave dhe nuk e di se sa kanë me mujt me i plotësua kërkesat e qytetareve të cilat janë të nevojshme për fshatin pastaj si do të realizohen ato kur një administrator tani do t'i përfaqësoj dy ose tri fshatra.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, draft rregulloren nuk e kemi bërë ne e ka bërë niveli qendror dhe niveli qendror nuk na ka përcaktu vetëm neve numrin mirëpo ja ka përcaktu gjitha komunave të Kosovës.

Azemine Bujupi-Gjoka, a kanë me u pagu administratorët të cilët janë kompetent për me i realizua kërkesat e qytetareve të cilat janë të nevojshme dhe janë në prioritet për secilin fshat.

Nënkryetari i Komunës Arben Shala, neni 16 i rregullores parashihet kompensimi i këshillave lokale ku thotë se kompensimi i këshillave të fshatit bëhet vetëm për gjashtë takime të këshillave të fshatit të mbajtura gjatë vitit kalendarik.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, (Për) votuan 19 anëtar, 7 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim bartja e mjeteve financiare nga kategoria rezerva.** Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, (Për) votuan 00 anëtar, kundër 0, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030.** Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, (Për) votuan 22 anëtar, 4 kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

Drin Halilaj- Deshta me ngrit një çështje lidhur me një shqetësim që e kanë banoret e rrugës “Ilaz Kodra” d.m.th. prej rrethit të ri deri të Komuna veturat aty lëvizin me shpejtësi shumë të madhe, dhe banoret janë të rrezikuara prej atyre veturave çdo ditë, është a ka mundësi Komuna me bë vendkalime p.sh. qysh është përballë çerdhes mu vendos një i ngjashëm edhe aty, kam edhe një shqetësim tjetër ne Komitetin për Komunitete ku unë jam Kryesues, përfaqësuesi i bizneseve që është aty anëtar nuk ka qene prezent ne asnjë mbledhje ne i kemi mbajtura 4 Mbledhje ne kemi bisedu me te aj nuk ka qene ne dijeni për propozimin e vet që është bere ne atë Komitet, Sokol Gashani është anëtar a ka mundësi me mbledhjen e ardhshme me ardh me një propozim tjetër me një emër tjetër sepse kem pak anëtar edhe mungesa e tij, po kemi problem edhe për kurum ne atë Komitet.

Ramiz Lladrovci- Rruga “Ilaz Kodra” është rrugë e përcaktuar me me ligj, me vendos pengesa nuk mundemi sepse i kam kontaktua ekspertet e rrugëve është nëse nuk gabo 50 km në or shpejtësia është 4 korsi, jemi duke menduar me be me 3 korsi edhe me liru një korsi për shteg të biçikletave sepse nuk kemi edhe sepse i fitojmë edhe 3 pikë ne përformancë komunale ku i sjellin ne dobi komunës qofte edhe me ato 3 pike, ndërsa sa i përket përfaqësuesit ka me bisedu me të, nëse nuk mundet me ardh duhet me tregu që nuk mundet me ardh edhe ne me zëvendësua me një tjetër, edhe statuti e thotë rregullorja në qoftë se në disa mbledhje nuk merr pjese ai vetvetiu e hup te drejtën e pjesëmarrjes.

Filloreta Bujupi- Përshëndetje deshta mu lidh pak ma herët Kryetari e murr si shembull pronën ne Arllat deshta me ja kujtu Kryetarit atë pronë e kemi pas në shfrytëzim aq kemi pagu taksa, ndërsa tash e ka rrit hapësirën edhe normal qe mundet me pas taksa tjera, deshta me pyet kryetarin a është në dijeni a e ka bërë një punë me vetëdije të plotë duke pas parasysh sa e ka demtu atë pjesë, tha kryetari qe janë 37 punëtor ne pompën e benzinës IP është zotu në kriteret e punësimit që kem mi pas 37 punëtor të kompanisë së vet jo të kompanisë që e kanë lëshuar me qira kompaninë Hebs, në kontratë thuhet që nuk kemi të drejtë me leshu me qira ndërsa kryetari ja ka aprovu me leshu me qira Hebsin, nuk janë 37 punëtor Kryetar IP por janë të Hebsit.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- znj. Bujupi nuk kisha pas dëshirë me kujtua atë temë ajo është teme e mbyllur ju keni bere kontrate për 10 ari po i keni shfrytëzua 50 Ari sepse ka qenë e tera ne shfrytëzim tuajin, i keni shkel te gjitha rregullat, Kompania IP se çka ka në Hebs e ka obligim atë prone prej sa ari i ka me me i punesu aty 37 punëtore po te gjithë punëtorët aty numërohen edhe mbikëqyrën edhe prej anës tonë.

Filloreta Bujupi a ke dergu ndonjë inspektor me përcjell atë pjese a je duke i dergu sot mi përcjell se çka është duke u zhvilluar ne atë pjese, apo vetëm pot interesojnë interesat e tuja personale edhe done m shantazhu, mos merr shembuj ku i dëmtton qytetaret në jemi qytetar të Komunës se Drenasit jemi qytetar qe te kemi votu për me i mbrojte jo me i shantazhu.

Egzona Tërdevci- unë e kam një kërkesë prej taxi qe janë këtu të rrethi afër shkollës ata janë ankuar që paguajnë taksat e rregullt nuk e di sakte vetëm po e përcjelli kërkesën e tyre por parkingu që e gëzojnë ata nuk i plotësojnë kushtet, a mundeni me tregu nëse ka mu be diçka për parkingun që ata e kanë në shfrytëzim.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- Kërkesa duhet me i protokollu në Komunë, do kërkesa qe i kanë bere dul qe vetëm një person i ka berë, taksistëve jemi duke jua rregullua pronën për me pas mundësi ata me zhvillu veprimtarinë e vet për te cilën paguajnë takse komunave pra jeni ne procedura.

Egzona Terdevci- e kam thënë edhe me herët ne jemi përfaqësues të popullit edhe detyrë e jona është që kërkesat e tyre që i adresojnë të ne me i paraqitë tek ju, nuk e di nëse e kanë bërë kërkesën të protokolluar mirëpo ne momentin qe adresohet te unë si asamblistë kam obligim me paraqite te ju.

Beqir Kiqina-sa i parket pikës tek të ndryshme kisha dashtë një kërkesë të qytetaret e Drenasit lidhur me emblemen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ose shqiponjën dy krenare që gjendet afër lokacionit të Komunës se vjetër dhe gjykatës a kish pas mundësi drejtoria për shërbime publike ose cilado drejtori që është kompetente në këtë aspekt të merr masa dhe pastroje vendin aty t'i largoj disa mbeturina ose të kemi një përgjigje nga Komuna çka duhet te veproj lidhur me këtë objekt.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- ke qenë asamblistë edhe ne asamblenë e kaluar e dini qe ka është njëvendim.

Hamit Haxhiu- ne vitin 2015 nga Kuvendi Komunal është marr vendim për kompensimin e lehonave ai vendim është ende ne fuqi dhe asnjë here nuk është realizu, pse nuk implementiohet ai vendim.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci –çdo vendim që ka bazë buxhetore që aprovohet nga Kuvendi implementohet vendimi, kështu që nuk kemi nda mjete për atë qëllim.

Hamit Haxhiu –nëse nuk mundesh kryetar atëherë shfuqizoje atë vendim.

Mehedin Salihu –përsëritet për të gjithë, deshta të filloj me Drejtorin e Arsimit në Shkollën e Mesme Profesionale në shpalljen e rezultateve me 30.06.2022 për pranimin e nxënësve të rinj prej 3 anëtarëve të komisionit vetëm një anëtarë e ka nënshkruar listën e publikuar për personat e pranuar, nëse është aq e thjeshtë edhe nuk kanë nevojë ata dy anëtarët e tjerë të komisionit me nënshkruar pse në qitni 3 nuk po leni vetëm një anëtar. Për shkak të temperaturave të larta në të cilat jemi asnjë qendër e mjekësisë familjare nuk është pajisur me klimatizim është e pamundur me punu pa klimë, është një numër i vogël i punëtorëve teknik shërbyes të cilëve u vazhdohet kohëve të fundit i vazhdohet kontrata herë 2 muaj herë 3 muaj a ka ndonjë zgjidhje për ta? Banorët e Drenasit V kërkojnë rregullimin e urës në Shtrubullova sepse është e ngushtë nuk mundën me kalu as këmbë as ka korsi për këmbësor rruga është me të vërtetë e dëmtuar.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci- taksa komunale vendoset në baze të rregullores edhe në bazë të ligjit, kush do që ka me pagu takse nuk ka nevojë me prit e ka obligim me pagu çdo 3 muaj ose të paktën në fund të vitit ato taksa që cilat nuk kemi drejt mi fal janë taksa që e përcakton ligji dhe niveli qendror ato nuk mundemi me i fal. Drenasi V projekti i rregullimit të shtratit të lumit e ka ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor të cilës i kanë bere vërejtje dhe padi sepse e kanë përfunduar një segment e kanë lan segmentin e mesit dhe kanë dal ne segmentin e tret ata e kanë obligim me ndreq shtratin e lumit dhe urën, punonjësve teknik po jua vazhdojnë ka 2 muaj 3 ju e dini që hatri tyre përshkoq qe ju po na kritikoni për mos pastërti e tere kjo për shkak te atyre punëtorëve nuk ka me të drejte për t'i dhënë kontrata të përhershme, për klima nuk jeni pa klima ju e dini që keni klima.

Muhamet Gjoka-sa i përket pyetjes për nënshkrim të komisionit të farmacia edhe një lëshim sigurisht teknik të paktën unë nuk ka me pasur asnjë ankese lidhur për mos pajtimin e komisionit është çështje teknike kur është publikuar rezultati.

Mehedin Salihu ka drejte vetëm një anëtar i komisionit me nënshkruar edhe a është e vlefshme ?

Muhamet Gjoka- nëse janë tre anëtarë të komisionit atëherë duhet të jetë nga të tre anëtarët e nënshkruar.

Mehedin Salihu, sa i përket taksës komunale a ka mundësi që me i zvogëlu taksen komunal, taksat janë të pa përballueshme duke pas parasysh punën që e kanë bizneset tona. Çështja tjetër në QKMF dhe në qendra të tjera të mjekësisë familjare nuk kam shiku se ka klima, nuk është kosto e shtrenjte për me i vendos klimat.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, taksen e përcakton një komision të cilin jemi duke e përgatit me e formu rregulloren e re për Taksa Tarifa dhe Gjopa janë propozimet që mundeni me i bë.

Mehedin Salihu, për punëtorët teknik-shërbyes a ekziston ndonjë mundësi me ja vazhdu për 6 muaj mos ja vazhdu vetëm për një muaj dy deri sa të behet një zgjidhje për ata.

Azemine Bujupi-Gjoka, në lagjen Mulaj një kandidat i cili ka bërë shumë kërkesa me e shtrur një rrugë për lagjen Mulaj në fshatin Terstenik që quhet “Dan Bekaj” këtë rrugë e kanë lëshuar ata vetë pra nuk është rrugë shoqërore pra ata i kanë përfunduar procedurat të noteri siç është kërkuar dhe e kanë bërë deklaratën nën betim dhe jemi betuar se nuk do të kërkojmë dëmshpërblim prandaj edhe pse ju i keni thënë me bërë kërkesë prapë se prapë nuk ia keni realizuar kërkesën.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, kush do që e ka dhënë pronën e vet private e ka regjistruar në kadashtë në komunë pronë publike ne e kemi dhënë një zotim që do t’i shtrojmë rrugën, çdo rrugë publike në komunën tonë do ta ndërtoj.

Labinot Halilaj, Kuvendi Komunal në regjistraturën e kaluar kemi qenë njëra ndër komunat se gjitha bizneset i kemi liruar nga taksa komunale vitin e kaluar tani që ka filluar një rigjenerim i ekonomisë mirëpo lufta në Ukrainë prapë ka shfaqur krize globale dhe mirë është më i rishiku prapë rregulloren për taksa dhe tatime por mos të cekim që komuna nuk ka bërë për biznese sepse komuna ka bërë kur është dashur për biznese.

